



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Adresa: Kontrolli i Lartë i Shtetit Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 545/9 Prot.

Tiranë, më ____09.2018

V E N D I M

Nr. 121, Datë 06.09.2018

P Ë R

AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË DIBËR ME OBJEKT "AUDITIM FINANCIAR PËR PERIU DHËN 01.01.2017-31.12.2017 DHE PËRPUTHSHMËRIE PËR PERIU DHËN 01.01.2016-31.12.2017.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Dibër dhe 14 Njësitë Administrative, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar (me rezervë). Fushat kryesore në të cilat janë konstatuar gabime janë në zhvillimin të procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave të punimeve.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", me qëllim përmirësimin e gjendjes,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar në Bashkinë Dibër për periudhën 01.01.2017-31.12.2017 (auditim financiar) dhe Bashkinë Dibër për periudhën 01.01.2016-31.12.2017 (auditim përputhshmërie), sipas programit nr. 545/1, datë 03.05.2018 dhe shtesës nr. 545/2, datë 13.06.2018 dhe nr. 545/3, datë 25.06.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinion i kualifikuar

Përgjegjësia e Auditit të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vëretësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të Pasqyrave Financiare dhe Raportimit

Financiar. Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700¹ dhe ISSAI 1200² shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Bashkisë Dibër, duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në periudhën nën auditim. I njëjti opinion vlen edhe për pasqyrën e realizimit të buxhetit.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për anomali me ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit, dhe që kanë ndikim në vendimmarjen e përdoruesëve të pasqyrave financiare.

Kemi konstatuar se për disa llogari të aktivitetit të bilancit, mungojnë të dhënat analitike mbi përmbajtjen e veprime kontabël cka i bëjnë ato të pa sakta:

Llogaria 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*”, për vlerën kontable në pasqyrat financiare 196,290,870 lekë. Kjo llogari bazuar në aktin e rakordimit me thesarin për vitin 2017, është debituar për vlerën 326,690 mijë lekë.

Mungojnë të dhënat analitike, për llogaria 231 është kredituar në debit të llogarive të investuara e të përfunduara si objekt.

Llogaria 230 “*Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara*”, për vlerën kontabël 10,366,453 lekë.

Në këtë llogari është kontabilizuar *vlera 1,124,030 lekë*, mbartur nga vitet e mëparshme nga ish Komuna Melan por e pa evidentuar me analizë për përmbajtjen e saj. Kurse diferenca për vlerën 9,242,423 leke përfaqëson shpenzime për financimin e projekteve gjatë vitit 2017 e analizuar për 9 projekte.

Llogaria 211 “*Pyje, kullota plantacione*”, për vlerën kontabël 1,268,000 lekë.

Është mbartur nga viti 2016 me vlerë 1,268,000 leke për të cilën nuk ka të dhëna analitike për përmbajtjen e kësaj llogarie, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30.

Llogaria 532 “*Vlera të tjera*”, për vlerën kontabël 1,481,900 lekë. Nga auditimi konstatohet se kjo llogari, nuk pasqyron saktë gjendjen faktike. Në fakt, në këtë llogari, duhet të pasqyrohej vlera kontable prej 6,755,600 lekë gjendje arke të letrave me vlerë, referuar ditarit të hyrjeve dhe daljeve të arkës për letrat me vlerë.

Nga auditimi, u konstatua se vlera 1,481,900 lekë, është kontabilizuar në debi të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” me analizë detyrime të pa pakuara për çerdhe dhe fatura të pa - **Për**

¹Objektivi i audituesit është të formulohet një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

²Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përse i takon gjetjeve nga auditimi.

procedurat e prokurimit publik

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë² e veprimtarisë së Bashkisë Dibër (ISSAI 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”³) e veprimtarisë së Bashkisë Dibër.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë⁴ e procedurave të prokurimit publik, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti Bashkia Dibër, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), bazuar në ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, “Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë”, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të cilat konsistojnë:

- Shkelje të kuadrit rregullator në fuqi në fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, lidhur me kriteret e vendosura në DST. Për arsye të skualifikimit të operatorëve ekonomikë si pasojë e kriterëve të vendosura në DST dhe devijimeve të vogla të parashikuara në ligj, dhe OE të shpallur fitues edhe pse në kushtet e mosplotësimit të DST, pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën 534 milion lekë, e cila përbën 60 % e vlerës së kontratave të lidhura dhe në 3 nga 14 raste për dëmin ekonomik në vlerën prej 51,552,315 lekë, si rezultat i kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE apo BOE të cilët nuk kanë plotësuar kërkesat e DST, në të njëjtat kushte me OE e s’kualifikuar por me ofertë ekonomike më të lartë se ato të s’kualifikuar.

Në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve, në 9 raste u konstatuan shkelje për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe moslogaritje penalitet për vonesa në realizimin e investimeve, të cilat kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të njësisë vendore në vlerën totale 17.6 milionë lekë.

Opinion: sipas mendimit tonë Nga auditimi i përputhshmërisë, i kryer në subjektin Bashkia Dibër, u konstatuan devijime/shkelje materiale nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat japim **një opinion të kualifikuar të përputhshmërisë**⁵.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI 1700⁶ dhe standarde ISSAI 1200⁷). Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi. Aktiviteti menaxhues dhe kontrollues, ushtrohet në kushtet e mungesës së një kuadri të plotë rregullator;

-Bashkia Dibër, nuk ka miratuar kodin e etikës profesionale për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

³ ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

⁴ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH-së”.

⁵ ISSAI 4000- 4200 – Audituesi shpreh një konkluzion të kualifikuar kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë materiale sa të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.

⁶Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

⁷Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

-Në këtë Njësi Qeverisjes Vendore, nuk aplikohen programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar.

-Struktura Organizative e Bashkisë Dibër, është miratuar me VKB nr. 108, dt. 20.12.2017, për numrin maksimal të punonjësve, kurse me urdhër të Titullarit të Bashkisë nr. 35 datë 01.03.2018 është miratuar struktura organizative.

Nga 501 punonjës gjithsej të miratuar, 396 janë punonjës vende pune që trajtohen me kontratë sipas ligjit “Për kodin e punës” kurse 113 vende pune, vende pune që trajtohen me Statusin e Nëpunësit Civil, nga të cilët vetëm 93 vend pune e kanë fituar statusin e nëpunësit civil kurse diferenca për 15 vende pune, nuk janë ende me statusin e nëpunësit civil.

Për punonjësit që trajtohen me kontratë sipas ligjit “Për kodin e punës”, nuk janë lidhur kontrata pune me afat.

Në strukturën organike të miratuar, janë përcaktuar edhe lloji i arsimit për çdo pozicion, por në 6 raste të emërimeve, nuk përputhen arsimit sipas kërkesave të strukturës organizative.

Menaxhimi i riskut. Nga titullari i Njesisë Administrative, është caktuar koordinatori i riskut por nuk janë identifikuar sistemet e kontrollit me risk. Nuk është hartuar regjistri i riskut dhe për rrjedhojë nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij. Aspektet e riskut nuk njihen dhe kuptohen në nivelin e duhur nga strukturat drejtuese të njësisë.

Nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

Veprimtaria e GMS, nuk ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore, për arsye se:

GMS, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32.

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, realizohet në mënyrë formale duke respektuar ato kritere mbi të cilat edhe raportohet pranë Ministrisë së Financave.

Nuk janë përcaktuar rregulla të qarta lidhur me ndjekjen e zbatimit të kontratave të lidhura pas procedurave të prokurimit me tender.

Për projektet në bujqësi, arsim, urbanistikë, infrastrukturë etj., në rregulloren e funksionimit të brendshëm nuk janë përcaktuar detyra se kush duhet të ndjekë zbatimin e kontratave lidhur me afatet dhe cilësinë e punimeve (*trajtuar më hollësisht në faqet 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër të merren masat e nevojshme për implementimin e kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit”, i ndryshuar.

Të merren masa për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore duke zbatuar strukturën organizative të miratuar, plotësimin e vendeve që trajtohen me Statusin e Nëpunësit Civil sipas ligjit, me procedurën e konkurrimit.

Të merren masa për identifikimin e aktiviteteve me risk dhe për menaxhimin e tij.

Brenda Muajt Tetor 2018

2. Gjetje nga auditimi. Në Bashkinë Dibër, është organizuar dhe funksionon struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) si veprimtari vlerësuese dhe që jep siguri mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Kjo Njësi, është e përbërë nga dy specialistë si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit. Përgjegjësi i Sektorit, është i pajisur me Certifikatën e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik ndërsa 2 specialistet e tjerë nuk janë të pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” neni 11.

Në vitin 2016, NJAB, ka programuar dhe realizuar 4 auditime ndërsa në vitin 2017, ka programuar dhe realizuar 7 auditime.

Është miratuar nga Titullari i Bashkisë, Plani Strategjik i subjekteve për tu audituar për periudhën 2017, 2018, 2019, Plani i angazhimeve për vitin 2017, Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim për vitin 2017,

Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për 2017 dhe Risqet e identifikuara sipas sistemeve për vitin 2017.

Dokumentacioni i mësipërm i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshme pranë Ministrisë së Financave, me shkresën nr. 2735, dt. 18.10.2016.

Auditimet e kryera, janë evaduar me urdhër të Titullarit të Bashkisë ku janë marrë vendimet përkatëse për shkeljet e konstatuara.

Pavarësisht sa sipër u konstatuan se nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhër të Ministrave të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kap. II, pika 10, si dhe nuk është bërë e dokumentuar vlerësimi i riskut gjatë auditimit, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kap. VII “Sigurimi i cilësisë së auditimit të brendshëm-Pjesa Formatet Standard si dhe në të gjitha rastet nuk është dokumentuar takimi fillestar me organizatën ose projekt-axhenda (*trajtuar më hollësisht në faqet 166-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Mesëm

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër të merren masat e nevojshme për riorganizimin e NJAB me specialistë me kualifikimin e nevojshëm, të pajisur me *certifikatën e auditit të brendshëm, në zbatim të kërkesave ligjore*.

NJAB, të marrë masat e nevojshme për të rritur cilësinë e auditimeve në zbatim Standardeve dhe kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhër të Ministrave të Financave nr. 100, datë 25.10.2016.

Brenda Muajt Nëntor 2018

3. Gjetje nga auditimi. Buxheti i Bashkisë Dibër *për vitin 2016* është miratuar me VKB-në nr. 14, datë 11.04.2016 në kundërshtim me afatet ligjore. Të ardhura dhe shpenzimet janë programuar gjithsej për 1,897,422 mijë lekë me burime financimi si vijon:

Të ardhurat nga tatim taksat lokale për 76,257 mijë lekë,

Të trashëguara nga viti i kaluar për 66,138 mijë lekë,

Transferta e pa kushtëzuar (Granti) për 314,948 mijë lekë dhe

Transfertat e kushtëzuara për 1,441,079 mijë lekë.

Në total, treguesit e buxhetit, janë realizuar në masën 81%. Shpenzimet operative, llogaria 602, janë realizuar në masën 72%.

Një nga shkaqet e mos realizimit të këtij zëri, është fakti se fondi limit i programuar për 9 raste të blerjeve me procedurën e tenderimit, është parashikuar për vlerën 33,115 mijë lekë, prokuruar në fakt për vlerën 23,642 mijë lekë me efekt në mosrealizim për 5%.

Shpenzimet për investime, llogaria 230 dhe 231, janë realizuar në masën 48%. Në këtë mos realizim, kanë ndikuar:

Janë realizuar 7 procedura prokurimi në vlerën 7,920 mijë lekë, të cilat nuk u financuan gjatë vitit 2016 me efekt në mosrealizim për 1%.

Nuk janë realizuar 12 procedura prokurimi për vlerën 1,318 mijë lekë me efekt në mosrealizim për 1%.

Nuk janë financuar plotësisht gjatë 3 objekte të financuara nga FZHR për vlerën 275,056 mijë lekë me efekt në mosrealizim për 43%.

Për vitin 2017, buxheti i Bashkisë Dibër, është miratuar me VKB-në nr. 12, datë 9.03.2017 në kundërshtim me afatet ligjore. Të ardhura dhe shpenzimet janë programuar gjithsej për 2,042,150 mijë lekë me burime financimi si vijon:

Të ardhurat nga tatim taksat lokale për 81.630 mijë lekë,

Të trashëguara nga viti i kaluar për 69,140 mijë lekë,

Transferta e pa kushtëzuar (Granti) për 395.375 mijë lekë,

Transfertat e kushtëzuara janë në total 1.496.005 mijë lekë.

Në total, treguesit e buxhetit, janë realizuar në masën 90%. Shpenzimet operative, llogaria 602, janë realizuar në masën 89%.

Një nga shkaqet e mos realizimit të këtij zë, është fakti se fondi limit i programuar për 14 raste të blerjeve me procedurën e tenderimit, është parashikuar për vlerën 60,005 mijë lekë, prokuruar në fakt për vlerën 44,122 mijë lekë (me tvsh), me efekt në mosrealizim për 8%. Shpenzimet për investime, llogaria 230 dhe 231, janë realizuar në masën 69%. Në këtë mos realizim, kanë ndikuar:

Fondi limit i programuar për 27 objekte të prokuruar, është 333,311 mijë lekë, kontraktuar vlera 298,100 mijë lekë me efekt në mos realizim 5%.

Nuk janë kryer procedurat e prokurimit për 3 objekte “Studime dhe projektme” për vlerën 3,239 mijë lekë me efekt në mosrealizim për 1%.

Nuk janë financuar plotësisht gjatë vitit 2 objekte të financuara nga FZHR për vlerën 120,635 mijë lekë me efekt në mosrealizim për 22%.

Për 8 objekte për vlerën 54,916 mijë lekë, janë kryer vetëm procedurat e prokurimit dhe nuk u financuan gjatë viti me efekt në mosrealizim për 8% (*trajtuar më hollësisht në faqet 23-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër, të marren masat për përgatitjen e një buxheti sa më real. Të merren masa e nevojshme, me qëllim që të gjitha investimet e programuara, të realizohen sipas afateve të parashikuara në treguesit e buxhetit.

Të merren masat që programimi i fondit limit, të bëhet sa më real, bazuar në projekte dhe preventivat përfundimtar

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi. Llogaria aktive e bilancit 202 “*Studime e projektme*” për vlerën kontabël 42,028,503 lekë, është e analizuar për 63 projekte dhe studimeve të financuara në vite. Nga auditimi u konstatua se administrimi i projekteve dhe studimeve, nuk është bërë bazuar në inventarizimin fizik të tyre, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73 (*trajtuar më hollësisht në faqet 23-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I mesëm

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër të merren masat, të verifikohet saktësia e llogarisë 202 “*Studime e projektme*” bazuar në inventarizimin mbi gjendjen fizike të studimeve dhe projekteve të financuara në vite.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi. Llogaritë e aktivitetit të bilancit 31 dhe 32, nuk pasqyrojnë gjendjen reale sipas rezultateve të inventarizimit fizik të kryera në fund të vitit 2017.

Konkretisht llogaria 31 “*Materiale*”, për vlerën kontabile të pasqyrave financiarë, 7,234,383 lekë.

Sipas rezultateve të inventarizimit fizik, rezulton se gjendja fizike për këtë llogari është në shumën 17,069,395 lekë. Në këtë rast, pasqyrat financiare *nuk pasqyrojnë gjendjen reale për diferencën* (17,069,395- 7,234,383)= 9,835,012 lekë.

Llogaria 32 “*Objekte inventari*” për vlerën kontabël 15,570,200 lekë.

Sipas rezultateve të inventarizimit fizik, rezulton se gjendja fizike për këtë llogari është në shumën 5,634,232 lekë.

Në këtë rast, pasqyrat financiare *nuk pasqyrojnë gjendjen reale për diferencën* (5,634,232- 15,570,200)= 9,935,968 lekë, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30 (*trajtuar më hollësisht në faqet 23-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër të sistemohet llogaritë inventariale nr. 31 dhe 32 në vlerat sipas rezultateve të inventarizimit fizik.

Brenda Muajit Tetor 2018

6. Gjetje nga auditimi. Për disa llogari të aktivitetit të bilancit, mungojnë të dhënat analitike mbi përmbajtjen e veprimeve kontabël çka i bëjnë ato të pa sakta:

Llogaria 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*”, për vlerën kontabile në pasqyrat financiare 196,290 mijë lekë. Kjo llogari bazuar në aktin e rakordimit me thesarin për vitin 2017, është debituar për vlerën 326,690 mijë lekë.

Mungojnë të dhënat analitike, përse llogaria 231 është kredituar në debit të llogarive të investuara e të përfunduara si objekt.

Llogaria 230 “*Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara*”, për vlerën kontabël 10,366,453 lekë.

Në këtë llogari është kontabilizuar *vlera 1,124,030 lekë*, mbartur nga vitet e mëparshme nga ish Komuna Melan por e pa evidentuar me analizë për përmbajtjen e saj. Kurse diferenca për vlerën 9,242,423 leke përfaqëson shpenzime për financimin e projekteve gjatë vitit 2017 e analizuar për 9 projekte.

Llogaria 211 “*Pyje, kullota plantacione*”, për vlerën kontabël 1,268,000 lekë.

Është mbartur nga viti 2016 me vlerë 1,268,000 leke për të cilën nuk ka të dhëna analitike për përmbajtjen e kësaj llogarie, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30.

Llogaria 532 “*Vlera të tjera*”, për vlerën kontabël 1,481,900 lekë. Nga auditimi konstatohet se kjo llogari, nuk pasqyron saktë gjendjen faktike. Në fakt, në këtë llogari, duhej të pasqyrohej vlera kontabile prej 6,755,600 lekë gjendje arke të letrave me vlerë, referuar ditarit të hyrjeve dhe daljeve të arkës për letrat me vlerë.

Nga auditimi, u konstatua se vlera 1,481,900 lekë, është kontabilizuar në debi të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” me analizë detyrime të pa paguara për çerdhe dhe fatura të pa likuiduara dhe si e tillë nuk duhej të ishte në debi të llogarisë 532 (*trajtuar më hollësisht në faqet 23-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër të sistemohet llogaritë e aktivitetit të bilancit 230, 231, 211, 532 bazuar në të dhënat analitike dhe të vërtetuara në dokumente kontabël.

Brenda Muajit Nëntor 2018

7. Gjetje nga auditimi. Sipas të dhënave të pasqyrave financiare gjendja e debitorëve në Bashkinë Dibër, llogaria 468, është 34,313 mijë lekë kurse detyrimet kreditore, llogaritë 401-408, është 169,631 mijë lekë që përfaqëson 9% të totalit të shpenzimeve faktike (*trajtuar më hollësisht në faqet 23-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

7.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër të merren masat për të ulur borxhin ndaj të tretëve, duke programuar në buxhetin e çdo viti, likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Vazhdimisht

8. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi u konstatua se në 4 raste për vlerën 21,466,156 lekë, nuk janë kontabilizuar detyrimet e pa paguara për punime të kryera nga subjekte sipërmarrëse të punimeve, për rrjedhojë në pasqyrat financiare, nuk jepet informacion mbi këto detyrime.

Konkretisht për objektet:

“*Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse Sllovë, Luzni, Selishtë, Kastriot Fushë-Cidhën*”. Vlera e pa paguar 1,236,939 lekë.

“*Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje kanaleve vaditëse Maqellarë, Melan, Muhur, Tomin*”. Vlera e pa paguar 2,693,154 lekë.

“Sistemim Asfaltim lagja “Gj. Doci” zona pas ish Komitetit Ekzekutiv dhe pas ish policisë dhe zona ku ka përfunduar Rrjeti Ujësjellësi i Ri dhe lagjia. V. Dibra zona poshtë shkollës 9 vjeçare ku ka përfunduar Rrjeti Ujësjellësi i Ri”. Vlera e pa paguar 4,881,736 lekë.

“Rikonstruksion Ish zyrat e Ndërmarrjes Ura Peshkopi+ sistemim ngrohje + Rrethim i jashtëm i objektit Ish zyra e ndërmarrjes Rruga Ura Peshkopi”. Vlera e pa paguar 12,654,327 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 23-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

8.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër të merren masat për të kontabilizuar në çdo rast detyrimet e pa paguara ndaj të tretëve, bazuar në dokumentet ligjorë.

Vazhdimisht

9. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Dibër, nga zbatimi i reformës administrative duke analizuar treguesit e deri tanishëm konstatohet se nuk ja ka arritur qëllimit në stadin bashkëkohor të kërkuar pasi:

- Ka një rritje të numrit të punonjësve të bashkisë prej 110 veta edhe pse numri i përgjithshëm duhet të ishte në ulje, nisur nga fakti se nga përthithja e ish-komunave janë shkurtuar 89 veta ish-punonjës;

- Ka rritje të shpenzimeve të personelit (600 +601 në vitin 2017 në krahasim me vitin 2014 respektivisht në vlerën 98.341.883 leke për paga dhe 13.438.898 për kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore si pasojë e rritjes së numrit të punonjësve dhe rritjes së kategorive të pagave sipas strukturës së re;

- Mos realizimi i të ardhurave nga sistemi i tatim taksave lokale, më pak për 18.225.632 lekë, krahasuar me të ardhurat e realizuara për vitin 2014;

- Pa barazia në përfitim të projekteve të investimeve sipas Nj A dhe kërkesave të larta për investime në infrastrukturën rrugore atë të vaditjes, ujësjellës-kanalizime e objekte shkollore.

- Mos marrja në kohë e disa shërbimeve për banorët e disa njësive administrative të thella e larg nga qendra e bashkisë, për shkak të sipërfaqes madhe e territorit të bashkisë prej 1.001 km² si dhe rrjeti rrugor shume i dëmtuar në disa zona që vështirëson lëvizjen e njerëzve drejt qendrës së Bashkisë (trajtuar më hollësisht në faqet 35-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Niveli i Prioritetit

I ulët

9.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër të merren masa për zbatimin e reformës administrative, duke krijuar një strukture organizative eficiente në referim të numrit të përgjithshëm të banorë, me qëllim ushtrimin me efektivitet dhe ekonomikitet të funksioneve bazë të njësive dhe veçanërisht realizimin e të ardhurave nga sistemi i taksapaguesve dhe për një shpërndarje sa më racionale të fondeve për investime.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi. Në 2 raste në zbatimin e kontratës për punë publike “Rehabilitim i kanalit ujitës Llixha-Brezhdan-Kander dhe kanali Gurra Venisht, Bashkia Dibër” të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër dhe nga shoqëria “N.” Shpk, nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit në objekt u konstatua se, në disa segmente janë shkaktuar dëmtime të veshjes me beton të kanaleve dhe kanalet kanë filluar të mbushen me mbetje dhe bimësi duke u bërë pengesë për lëvizjen e ujit (trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Niveli i Prioritetit

I ulët

10.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër t’i kërkojë shoqërisë “N.” Shpk, të marrë masa për riparimin e defekteve të konstatuara në veshjen me beton të klasës C 12/15 në kanalet ujitëse, si dhe të realizojë pastrimin e tyre nga bimësia dhe mbetjet e ndryshme si detyrim kontraktual i përcaktuar në kontratën dy paleshe.

11. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dosjes teknike të “Ndërtimi i shkollës së mesme të përgjithshme Maqellarë”, Bashkia Dibër, rezultoi se ky objekt ishte prokuruar dhe zbatuar pa marrë leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe pa projekt konstruktiv, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, nenin 5 (*trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I ulët

11.1. Rekomandim: Nga Bashkia Dibër të merren masa që, para hedhjes së objekteve në sistemin elektronik të prokurimeve, të ndiqen procedurat e marrjes së lejes së ndërtimi dhe hartimi i projekteve të plota të zbatimit, në mënyrë që objektet të realizohen sipas projektit dhe preventivit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi. Në adresë të KLSH është administruar me nr. 761, datë 25.06.2018, ankimi i paraqitur nga qytetari H. H. M., ankim i bërë në cilësinë e trashëgimtarit të të ndjerit H. B. M.. Sipas ankesës Bashkia Dibër, nuk zbaton detyrimet ligjore për lëshimin e Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi në emër të H. M.. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Dibër (Relacioni/shkresa nr. 2926, datë 04.07.2018) si dhe vlerësimi i dokumenteve të paraqitura në KLSH nga ankuesi, rezulton se Bashkia Dibër nuk ka përbushur plotësisht detyrimin ligjor lidhur me shqyrtimin e praktikës, vlerësimin e dokumentacionit, krijimin e korrespondencës së plotë me institucionet përkatëse etj, duke mos kryer plotësimin e titullit të pronësisë mbi tokë bujqësore, në mos respektim të afateve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara nga VKM nr. 253, datë 06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrës së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”, si dhe VKM nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore” dhe VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara” (*trajtuar më hollësisht në faqet 182-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I ulët

12.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit, të realizoj në mënyrë të plotë e profesionale procesin e vlerësimit të kërkesës për lëshimin e titullit të pronësisë mbi tokë bujqësore për H. M., procesi i cili duhet mbështetur në kriteret ligjore dhe afat kohore të përcaktuara ligjërisht, duke u referuar plotësisht në dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi si dhe korrespondencat e krijuar me institucione të tjera lidhur me kalimin e tokës bujqësore në përdorim për qëllime bujqësore, si përfitues të ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, të cilët banojnë realisht në fshat dhe nuk janë sistemuar me punë e strehim në qytet a qendra të banuara”, sipas përcaktimit të pikës 2/paragraf i fundit të VKM nr. 255, datë 02.08.1991.

Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Sektorit të Administrimit të Pronave dhe Strehimit, të përgatisë dhe paraqes në Këshillin Bashkiak projektvendimin përkatës për të ndjerin H. M., me qëllim vlerësimin dhe shprehjen nga organi i ngarkuar me ligj (KB) me vendim (miratimi apo refuzimi) të plotësimit të titullit të pronësisë.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi. Në auditimin e dokumentacionit **mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e fundit**, konstatohet se nga Bashkia Dibër megjithëse është punuar në drejtim të zbatimit të tyre, akoma situata nuk është vlerësuar sa dhe si duhet, duke mos ndjekur deri në fund procedurat ligjore në zbatimin e rekomandimeve, kryesisht ato që kanë lidhje me shpërbllim dëmi, veprime në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr.

154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, dhe konkretisht masat e pa zbatuara janë:

Rekomandimet me Karakter Organizativ

3.1: Bashkia Dibër, të marrë masa për verifikimin në terren të statusit juridik të aseteve të qëndrueshme sipas listës të miratuar me *VKM nr.1533, datë 19.11.2008* dhe të veprohet sipas procedurave ligjore:

a. Në rastet kur asetet posedohen nga persona të tretë, të paautorizuar, të lajmërohen personat dhe të lidhen kontrata qiraje për trojet e lira, ndërtesat dhe trojet funksionale, duke kërkuar arkëtimin e të ardhurave të munguara.

8.1: Bashkia Dibër, të marrë masa që për mbledhjen e arkëtimin e taksave dhe tarifave nga popullata, të caktojë si agjent tatimor Ujësjiellësin sh.a Dibër dhe për realizimin e saj të përgatitet aktmarrëveshja e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak, si dhe të kryejë rakordimet periodike mujore/tremujore/vjetore.

18.1: Bashkia Dibër, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të ri kërkuara me shkresën nr. 950/7, datë 18.12.2014, në zbatim të kërkesave ligjore. Të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit të pa arkëtuar në shumën 5,969,635 lekë duke bërë kërkesë padi në Gjykatë ndaj subjekteve debitorë.

Rekomandimet për Shpërblim Dëmi

1.1: Të merren masa dhe të procedohet sipas kërkesave ligjore për shpërblimin e dëmit për vlerën **9,402,678 lekë**, nga 7 subjekte qiramarrës, në vlerën aktuale (pas shlyerjes së detyrimeve nga 6 subjekte në vlerën prej **8,720,073 lekë**) dhe mbetur pa paguar respektivisht:

-subjekti “G. R.” Shpk për vlerën **682,605 lekë**.

2.1: Të merren masa dhe të procedohet sipas kërkesave ligjore për shpërblimin e dëmit për vlerën **58,710,570 lekë** nga 38 subjekte të cilët kanë ndërtuar me leje ndërtimi, objekte mbi truallin publik dhe nuk kanë paguar vlerën e qerasë të truallit, sipas listës emërore të pasqyrës në fq. 137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4.1: Të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,527,086 lekë pa TVSH** për punime të pa kryera në fakt nga BOE “P. & B.-I.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën me objekt: “Sistemim Asfaltim Rruga e Fshatit Erebarë” ish-Komuna Maqellarë, Dibër.

5.1: Të merren masa për arkëtimin e vlerës **2,272,227 lekë pa TVSH** për punime të pa kryera nga OE “S.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën me objekt: “Punime Sistemimi Asfaltimi Rrugë të Brendshme, Trotuare” Bashkia Peshkopi.

6.1: Të marren masa për arkëtimin e vlerës **3,230,197 lekë** me nga 807,549 lekë nga KVO e përbërë: B. S., B. G., G. M. dhe z. B. A., për kualifikim dhe shpalljen fitues të BOE “E.” & “B.-I.” Shpk”.

7.1: Të marren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar **shpërblimin e dëmit në vlerën 329,017 lekë**, nga personat përgjegjës z. M. Z. për vlerën 18,153 lekë; z. N. M. për vlerën 15,925 lekë; z. S. C., për vlerën 22,150 lekë, z. Q. T., për vlerën 842 lekë, z. F. K., për vlerën 1,683 lekë, z. F. M., për vlerën 111,993 lekë, z. D. K., për vlerën 111,993 lekë, z. F. S., për sasinë 130 litra naftë të pa argumentuar me vlerë 23,140 lekë dhe z. Sh. L., për sasinë 130 litrave naftë me vlerë 23,140 lekë.

10.1: Të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **149,412 lekë** nga ish anëtarët e Këshillave dhe ish -Kryetarë të fshatrave të ish-Komunave Tomin me 34 raste për vlerën 78,662 lekë, Luzni me 16 raste për vlerën 26,880 lekë, Zall- Dardhë me 21 raste për vlerën 19,530 lekë dhe Sllovë me 23 raste për vlerën 24,340 lekë.

12.1: Të marren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **99,500 lekë**, nga anëtarët e komisionit të blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla; **D. K.**, për vlerën **33,167 lekë**; **znj.M. D.**, për vlerën **33,167 lekë** dhe **z. Q. T.**, për vlerën **33,166 lekë**.

Rekomandimet me Karakter Administrativ (Gjoba nga APP)

APP me vendimin nr. 30, datë 10.03.2017, ka vendosur masa dënim me gjobë për 7 persona në shumën **1,000,000 lekë**, (Sh. Xh. në vlerën prej 100,000 lekë, B. S., B. G. dhe G. M. në vlerën prej 150,000 lekë dhe A. B., A. B. dhe P. U. në vlerën prej 150,000 lekë), (*trajtuar më hollësisht në faqet 171-182 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

13.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe risin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërore. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu rikërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shpërblimit të dëmit, masave organizative me mungesë të ardhurash, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e perealizuara dhe rikërkua nga KLSH-ja.

Menjëherë

C.I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) – *Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **71,835,641 lekë**, nga të cilat **2,646,696 lekë**, në mos mbajtjen e penaliteve për punime jashtë afatit, **17,636,627 lekë** me tvsh në zbatimin e kontratave për punë publike dhe **51,552,315 lekë** në përzgjedhjen e ofertave fituese në procedurat e prokurimit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 71,835,641 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Përmirësim i infrastrukturës vendore dhe Rivitalizimi i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës*”, për vlerën prej **173,490,908 lekë**, me OE të shpallur fitues “**A. G. I. C.**” shpk, për vlerën prej 172,972,488 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 518,420 lekë, procedurë në të cilën kanë marrë pjesë 1 OE dhe 1 BOE. Është s’kualifikuar me të drejtë BOE për mungesë dokumentacioni dhe është kualifikuar OE që nuk plotëson këto kritere: **Pika 4**, kandidati duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton që për periudhën Maj 2015 – Maj 2016, ka pasur të punësuar për këtë periudhë mesatarisht jo më pak se 190 punonjës (duke përfshirë edhe stafin tekniko menaxherial). **Pika 4.1**, pjesë e stafit teknik të operatorit duhet të jenë: Ing. Ndërtimi, ing. Hidroteknik, ing. Mjedisi, etj. **Pika 5.4**, të ketë në listëpagesë mjekun e shoqërisë (referuar VKM nr. 742 datë 06.11.2003) për periudhën janar 2015 – mars 2016, kontratë pune, diplomë, CV licensë. Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori fitues A. I. G. C., nuk figurojnë në listëpagesë mjeku i shoqërisë, kontrata e punës, CV dhe licenca për periudhën e përmendur më sipër. OE ka marrë pjesë në 2 procedura prokurimi publik të zhvilluara në datën 25.07.2016 që janë: “Ndërtimi i shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë” dhe “Përmirësimi i infrastrukturës vendore dhe rivitalizimi i hapësirave publike në zonën pranë pallatit të kulturës”. Për të dyja procedurat e zhvilluara në këtë datë, administratori i OE, ka bërë deklaratimet për makineritë, punëtorët dhe stafin drejtues që i vë në dispozicion me kohë të plotë deri në përfundim të zbatimit të kontratës dhe se nuk janë të angazhuar në tendera të tjerë. Nga deklaratat e bëra, rezultojnë se janë të njëjtat mjete, të vëna në dispozicion për të 2 tenderat si dhe i njëjti staf drejtues. Përveç kësaj, për tenderin e zhvilluar në datë 20.05.2016 për “Rinovim i

infrastrukturës së bulevardit Elez Isufi, rrugës Safet Zhulali dhe rrugës së Muzeut”, administratori ka bërë deklaratë se makineritë, punëtorët dhe stafi drejtues i vë në dispozicion të këtij projekti me kohë të plotë deri në përfundim të kontratës. Në këto kushte, KVO duhet ta kishte s’kualifikuar këtë operator ekonomik dhe procedura duhej anuluar.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “A. I. G. C.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen Standarde të Tenderit, si dhe nga s’kualifikimi i BOE “G. C. & B. B. & Sh.”, me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën **151,256,242 lekë**, duke shkaktuar përdorim e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën **21,716,246 lekë** (diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të s’kualifikuar), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **21,716,246 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit (*Titullari i AK z. H. F. dhe anëtarët e KVO z. L. C., zj. K. R. dhe z. K. S.*), duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

2.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Ndërtimi i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë*”, për vlerën prej **79,675,817 lekë**, me OE të shpallur fitues “A. I. G. C.” shpk, për vlerën 78,972,628 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 703,189 lekë, procedurë në të cilën kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomikë (5 prej tyre nuk kanë paraqitur oferta) dhe kanë paraqitur oferta 1 BOE dhe 1 OE. Është s’kualifikuar me të drejtë BOE për mungesë dokumentacioni dhe është kualifikuar OE që ka këto mungesa në dokumentacion: **Pika 4.1**, pjesë e stafit teknik të operatorit duhet të jenë: Ing. Ndërtimi, ing. Hidroteknik, ing. Mjedisi, etj. **Pika 5.4**, të ketë në listëpagesë mjekun e shoqërisë (referuar VKM nr. 742 datë 06.11.2003) për periudhën janar 2015 – mars 2016, kontratë pune, diplomë, CV licensë. Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori fitues A. I. G. C., nuk figuron në listëpagesë mjeku i shoqërisë, kontrata e punës, CV dhe licenca për periudhën e përmendur më sipër.

OE ka marrë pjesë në 2 procedura prokurimi publik të zhvilluara në datën 25.07.2016 që janë: “Ndërtimi i shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë” dhe “Përmirësimi i infrastrukturës vendore dhe rivitalizim i hapësirave publike në zonën pranë pallatit të kulturës”. Për të dyja procedurat e zhvilluara në këtë datë, administratori i operatorit ekonomik, ka bërë deklaratim për makineritë, punëtorët dhe stafin drejtues që i vë në dispozicion me kohë të plotë deri në përfundim të zbatimit të kontratës dhe se nuk janë të angazhuar në tendera të tjerë. Nga deklaratat e bëra, bie në sy se janë të njëjtat mjete, të vëna në dispozicion për të 2 tenderat si dhe i njëjti staf drejtues. Përveç kësaj, për tenderin e zhvilluar në datë 20.05.2016 për “Rinovim i infrastrukturës së bulevardit Elez Isufi, rrugës Safet Zhulali dhe rrugës së Muzeut”, administratori ka bërë deklaratë se makineritë, punëtorët dhe stafi drejtues i vë në dispozicion të këtij projekti me kohë të plotë deri në përfundim të kontratës. Në këto kushte, duke qenë se ndodhemi para një deklarimi të pavërtetë, me qëllim pjesëmarrjen dhe fitimin e tenderit, KVO duhet ta kishte s’kualifikuar këtë operator ekonomik.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “A. I. G. C.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen Standarde të Tenderit, si dhe nga s’kualifikimi i BOE “G. C. & B. B. & Sh.”, me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën **69,184,076 lekë**, duke shkaktuar përdorim e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën **9,788,552**

lekë (diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të s'kualifikuar), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **9,788,552 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit (*Titullari i AK z. H. F. dhe anëtarët e KVO z. L. C., zj. K. R. dhe z. K. S.*), duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

3.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: "*Rinovimi i infrastrukturës së bulevardit "Elez Isufi", rrugës "Safet Zhulali" dhe rrugës së "Muzeut", për vlerën prej 92,272,248 lekë*, me OE të shpallur fitues "**A. I. G. C.**", për vlerën 87,324,219 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 4,948,029 lekë, procedurë në të cilën kanë marrë pjesë 2 BOE dhe 5 OE. Janë s'kualifikuar me të drejtë 4 OE dhe 2 BOE për mungesë dokumentacioni dhe është shpallur fituese OE e cila rezulton se nuk plotëson këto kritere: nga muaji korrik 2014 deri në muajin shkurt 2016, numri i punonjësve të këtij operatori nuk e plotëson kriterin e 150 punonjësve. Vetëm në muajt mars – prill 2016, numri i punonjësve është të paktën 150, çka dëshmon se ky operator nuk e plotëson gjatë të gjithë kohës këtë kriter të DST. Stafi teknik duhet të jetë i punësuar për të gjithë periudhën e mësipërme por në listëpagesat e paraqitura nga operatori, drejtuesit teknik të shoqërisë nuk figurojnë në listën e të punësuarve. OE nuk ka plotësuar kriterin "Fabrikë për prodhimin e betonit" dhe "Fabrikë për prodhimin e inerteve", pasi ka paraqitur kontratën për furnizim me nr. 5063/1 prot., nr. 3418/1 kol., datë 19.05.2016. Në përmbajtje të këtij dokumenti që ka gjithsej 3 fletë, konstatohet se është lidhur kontratë furnizimi me beton dhe inerte me shoqërinë "V." shpk, konstatohet se për "Fabrikën e prodhimit të betonit" nuk janë paraqitur: ekstrakt të regjistrit tregtar të subjektit furnizues, dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj (në rastin tonë të furnizuesit), planin e vendosjes, leja mjedisore Kodi III. 1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit ose leja mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Nuk plotëson dhe kriterin për drejtues teknik Ing. Mjedisi, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës të lidhur para noterit, diplomë, certifikatë IQT, si dhe CV.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik "**A. I. G. C.**" shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen Standarde të Tenderit, si dhe nga s'kualifikimi i BOE "**E. & B.-I. & E. M. & P.**", me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën **67,276,702 lekë**, duke shkaktuar përdorim e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën **20,047,517 lekë** (diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të s'kualifikuar), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **20,047,517 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit (*Titullari i AK z. H. F. dhe anëtarët e KVO z. L. C., zj. K. R. dhe zj. Z. Gj.*), duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i

ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

4. Gjetje nga auditimi: Në dy raste për vlerën **2,646,696 lekë**, nuk është llogaritur, kontabilizuar dhe arkëtuar penalitetet për mos dorëzimin në afat të punimeve sipas kushteve të kontratës **me dëm ekonomik:**

- Për objektin: *“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse Sllovë, Luzni, Selishtë, Kastrat, Fushë-Çidhën”*. Kontrata nr. 11/10 dt. 17.5.2017. Afati i përfundimit të punimeve, është data 7.06.2017. Penaliteti i llogaritur për 794,040 lekë. Sipërmarrës subjekti “R.” Shpk.

- Për objektin: *“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje kanaleve vaditëse Maqellarë, Melan, Muhur, Tomin”*. Kontrata nr. 24/16 dt. 9.05.2017. Afati i përfundimit të punimeve, është data 07.06.2017. Penaliteti i llogaritur për 1,852,656 lekë. Sipërmarrës subjekti “R.” Shpk (*trajtuar më hollësisht në faqet 23-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

4.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masat, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin nga sipërmarrësi “R.” Shpk të vlerës së penalitetit për **2,646,696 lekë**, për përfundim të punimeve tej afatit të parashikuar në kontratë, pa asnjë dokument shkresor për zgjatjen e afatit të punimeve, dhe për më tepër kur procedurat e prokuruarra janë realizuar në kushtet e nevojës emergjente.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rinovim i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, Bashkia Dibër*, me vlerë të kontratës 104,789,063 lekë me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “A. I. G. C.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 6,954,217 lekë me tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 23/24 prot datë 15.08.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër dhe Operatori Ekonomik “A. I. G. C.” Shpk (*trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Dibër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **6,954,217 lekë** me tvsh nga Operatori Ekonomik “A. I. G. C.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 23/24 prot datë 15.08.2016 me objekt *“Rinovim i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, Bashkia Dibër*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Sistemim asfaltim i rrugëve në lagje ku ka mbaruar ujësjellësi”, Bashkia Dibër*, me vlerë të kontratës **29,290,534 lekë** me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “E.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **661,474 lekë** me tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 77/15 prot datë 22.11.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër dhe Operatori Ekonomik “E.” Shpk (*trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Dibër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **661,474 lekë** me tvsh nga Operatori Ekonomik “E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. nr. 77/15 prot datë 22.11.2016 me objekt *“Sistemim asfaltim i rrugëve në lagje ku ka mbaruar ujësjellësi”, Bashkia Dibër*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rruga Borde - Peshkopi, Nj.A. Luzni”, Bashkia Dibër, me vlerë të kontratës 62,980,962 lekë me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “S.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 3,105,722 lekë me tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 48/18 prot datë 06.09.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër dhe Operatori Ekonomik “S.” Shpk (trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Nga Bashkia Dibër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,105,722 lekë** me tvsh nga Operatori Ekonomik “S.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 48/18 prot datë 06.09.2016 me objekt “Sistemim asfaltim rruga Borde-Peshkopi, Nj.A. Luzni”, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rruga Staravec-Shimçan-Zimur”, Bashkia Dibër, me vlerë të kontratës 48,811,224 lekë me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “S.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,997,682 lekë me tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 17/10 prot datë 08.06.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër dhe Operatori Ekonomik “S.” Shpk (trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandim: Nga Bashkia Dibër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,997,682 lekë** me tvsh nga Operatori Ekonomik “S.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 17/10 prot datë 08.06.2017 me objekt “Sistemim asfaltim rruga Staravec-Shimçan-Zimur”, Bashkia Dibër, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtimi i shkollës së mesme të përgjithshme Maqellarë”, Bashkia Dibër, me vlerë të kontratës 94,767,154 lekë me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “A. I. G. C.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 4,917,532 lekë me tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 56/15 prot datë 15.08.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dibër dhe Operatori Ekonomik “A. I. G. C.” Shpk (trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandim: Nga Bashkia Dibër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **4,917,532 lekë** me tvsh nga Operatori Ekonomik “A. I. G. C.” Sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 56/15 prot datë 15.08.2016 me objekt “Ndërtimi i shkollës së mesme të përgjithshme Maqellarë”, Bashkia Dibër, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C.II. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE (NË VLERËN PREJ 204,158,386 LEKË PA TVSH, NGA TË CILAT 148,796,521 LEKË NË PROCEDURAT E PROKURIMIT DHE 21,835,715 LEKË NË PROCEDURAT E ZBATIMIT TË INVESTIMEVE).

C.II.1. Gjetje nga auditimi: 1. Në objektin “Rinovim i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, Bashkia Dibër:

-“Box parafabrikat i kompletuar për furnizimin e ndriçimit” me vlerë 1,000,000 lekë, nuk është parafabrikat por me mur tulle dhe pa respektuar përmasat e përcaktuara në projektin e zbatimit.

- “Shtylla ndriçimi dekorative me dy krahë, me vlerë totale 1,066,464 lekë, janë realizuar me një ndriçues rrethor.

- Pusetat e betonit me kapak gize 40x40x40, me vlerë totale 251,384 lekë janë të përmasave më të vogla dhe pa kapak gize, por të mbuluara me pllakë guri.

Shuma totale prej **2,317,848 lekë** pa tvsh, është **shpenzim joefektiv** i kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve (*trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. Në objektin “Ndërtimi i shkollës së mesme të përgjithshme Maqellarë”, Bashkia Dibër:

-Zëri i punës “FV vetratë d/alumini plastike me dopioxham” me vlerë të situacionuar 1,724,195 lekë, nuk është kryer sipas përshkrimit të bërë në preventiv.

Vlera prej **1,724,195 lekë** pa tvsh, është **shpenzim joefektiv** i kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve (*trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.1. Rekomandim Titullari i AK të marrë masa që për kontratat publike, të caktojë nëpunës për monitorimin e kontratës, i cili të pasqyrojë gjendjen faktike të realizimit të kontratës, cilësinë e punimeve dhe grafikut të punimeve, para certifikimit të punimeve të realizuara.

Menjëherë

C.II.2.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “**Rehabilitim i fushës së mbetjeve urbane të bashkisë Dibër**”, për vlerën prej **4,022,549 lekë**, me BOE të shpallur fitues “**S. & H.**” shpk, për vlerën prej 3,926,108 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 96,441 lekë, procedurë në të cilën kanë marrë pjesë 3 OE apo BOE. Janë s’kualifikuar me të drejtë për mungesë dokumentacioni 2 OE me ofertë më të ulët, dhe është kualifikuar 1 BOE e cila nuk plotëson kriterin financiar, pika 3.1.b, duhen dorëzuar kopjet e vërtetuara të bilanceve të 3 viteve të fundit (2014, 2015, 2016). Operatori “H.” shpk, i ka dorëzuar të plota bilancet e viteve 2014 dhe 2015 (bashkë me raportin e ekspertit të pavarur kontabël), ndërsa mungon raporti i ekspertit për vitin 2016. Në lidhje me operatorin ekonomik “S.” shpk, ka dorëzuar vetëm bilancet e viteve 2014 dhe 2015 (edhe këto jo të plota, pasi mungon raporti i ekspertit të pavarur kontabël), Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “S.” & “H.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet, në vlerën 4,022,549 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **4,022,549 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.3.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rehabilitim i varrezave të dëshmorëve, Dibër 2017-2018”**, për vlerën prej **3,499,495 lekë**, me BOE të shpallur fitues **“Sh. & Sh.”** shpk, për vlerën prej 3,441,662 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 57,833 lekë, procedurë në të cilën kanë marrë pjesë 2 OE dhe 1 BOE. Janë s’kualifikuar me të drejtë 2 OE të cilët nuk kanë paraqitur ofertë ekonomike dhe është kualifikuar 1 BOE që nuk plotëson kriterin e kapacitetin teknik pika **3.1, pika C:** Një certifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka, ne leke, qe dëshmon se Kandidati/ofertuesi ka gjendje financiare ne vlere jo me te vogël se 10 % e fondit limit ne leke. Lëshimi te provoje se kjo gjendje financiare ndodhet ne llogarinë e ofertuesit jo me pare se 10 (dhjete) dite nga data e hapjes se ofertave. Ne rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet te paraqesë këtë dokument dhe gjendja financiare duhet të plotësohet nga secili pjesëtar i bashkimit në proporcion me % e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Nga auditimi rezulton se OE **“Sh.”** SHPK vërtetimi bankar i paraqitur është jashtë afatit 10 ditor pasi hapja e ofertave është data 17.07.2017, ndërsa vërtetimi i paraqitur nga kjo BOE përmban datën 26 maj 2017. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE **“Sh. & Sh.”** shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën 3,499,495 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 **“Për prokurimin publik”**, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **3,499,495 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasojë me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.4.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i urës HD=5 m, fshati Lishan i Poshtëm, N.J.A. Luzni”**, për vlerën prej **5,602,662 lekë**, me OE të shpallur fitues **“Xh.”** shpk, për vlerën 5,579,572 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 23,090 lekë, procedurë në të cilën kanë marrë pjesë 4 OE. Janë kualifikuar të 4 OE dhe nga dokumenti që na u vu në dispozicion i firmës së shpallur fituese, u gjetën këto mungesa në dokumentacion: OE **“Xh.”** shpk, ka dorëzuar pasqyrat financiare të viteve 2014, 2015, 2016, kopje e noterizuar nga Noteri Ilir Krashi, me nr. 4799 rep. në datën 13.06.2017, ndërkohë që afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit është data 09.06.2017 në orën 11:00. Përveç kësaj, pasqyrat financiare nuk janë të vullosura me vulën e drejtorisë rajonale tatimore. Në këto kushte, ky operator ekonomik duhej s’kualifikuar për arsye se i ka dorëzuar me 4 ditë vonesë dokumentacionin e nevojshëm për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE **“Xh.”** shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën 5,602,662 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 **“Për prokurimin publik”**, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për

mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **5,602,662 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.5.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse N.J.A. Maqellarë, Melan, Muhur, Tomin të bashkisë Dibër”**, për vlerën prej **6,463,338 lekë**, me BOE të shpallur fitues **“R.” dhe “F. shpk”**, për vlerën prej 6,175,521 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 287,817 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE dhe 1 BOE. Është shpallur fituese BOE e cila nuk plotëson kriterin e veçantë, vërtetim të gjendjes financiare, në llogarinë e operatorit të jetë jo më pak se 10% të fondit limit, të lëshuar jo më shumë se 5 ditë nga data e hapjes së ofertave. Çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë dokumentet e sipër kërkua. Ky kriter i veçantë nuk plotësohet nga ana e BOE të shpallur fituese, për arsye se vërtetimi i gjendjes financiare është paraqitur në datën 09.05.2017, pra një ditë pas hapjes së dokumenteve të tenderit nga ana e KVO dhe jo 5 ditë përpara siç kërkohet në kriterin e mësipërm. Përveç kësaj, ky dokument është paraqitur vetëm nga operatori ekonomik **“R.” shpk** ndërsa mungon një dokument i tillë nga operatori tjetër **“F.” shpk**.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE **“R. & F.” shpk**, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet, në vlerën 6,463,338 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 **“Për prokurimin publik”**, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **6,463,338 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.6.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje makine teknologjike”**, për vlerën prej **3,387,000 lekë**, me OE të shpallur fitues **“L. D.”**, për vlerën prej 3,380,000 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 7,000 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 3 OE. Janë s’kualifikuar me të drejtë 2 OE me ofertë më të ulët për mungesë dokumentacioni dhe është shpallur fituese OE e cila rezulton gjithashtu me mangësi në dokumentacion, pasi bilanci i vitit 2016 është pa firmë dhe pa vulë nga Dega e Tatim Taksave dhe nuk mund të merret për bazë si dhe nuk ka paraqitur dokumenta se posedon servis ose kontratë bashkëpunimi noteriale me servise që kryejnë shërbimet brenda distancës prej 10 km nga Bashkia Dibër. Pra procedura duhej anuluar.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik **“L. D.” shpk**, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet, në vlerën 3,387,000 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 **“Për prokurimin publik”**, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **3,387,000 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.7.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Shërbim projektim objektit rikonstruksion i rrugës kryesore ish-NBSH deri ish-SMT”**, për vlerën prej **5,000,000 lekë**, me OE të shpallur fitues BOE **“R. S. & C. C. G.”** Shpk, për vlerën prej 4,950,000 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 50,000 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 1 OE. Lidhur me këtë procedurë ka rezultuar se OE i shpallur fitues nga KVO nuk ka plotësuar kriteret dhe duhej skualifikuar, pasi nuk ka plotësuar kapacitetin teknik, pasi drejtuesi teknik dhe një Ing, edhe pse me kontratë të rregullt pune nuk figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Pra procedura duhej anuluar.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik **“R. S. & C. C. G.”** shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet, në vlerën 5,000,000 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **5,000,000 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.8.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Shërbim projektim objektit sistemim i përroit të llixhave, segmenti Ura e pazarit-Llixha”**, për vlerën prej **3,333,333 lekë**, me OE të shpallur fitues BOE **“R. S. & C. C. G.”** Shpk, për vlerën prej 3,290,000 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 43,333 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 1 OE. Lidhur me këtë procedurë ka rezultuar se OE i shpallur fitues nga KVO nuk ka plotësuar kriteret dhe duhej skualifikuar, pasi nuk ka plotësuar kapacitetin teknik, pasi drejtuesi teknik dhe një Ing, edhe pse me kontratë të rregullt pune nuk figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Pra procedura duhej anuluar.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik **“R. S. & C. C. G.”** shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet, në vlerën 3,333,333 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.8.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **3,333,333 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i

sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.9.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “**Rikonstruksion i varrezave publike Bashkia Peshkopi**”, për vlerën prej **2,409,554 lekë**, me OE të shpallur fitues “**D.**” Shpk, për vlerën prej 2,302,000 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 107,554 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 4 OE. 1 nga OE nuk kanë paraqitur ofertë, ndërsa 2 nga OE janë skualifikuar pasi kanë rezultuar me mangësi në dokumentacion nga të cilat 1 me ofertë më të lartë. Lidhur me këtë procedurë ka rezultuar se OE i shpallur fitues nga KVO nuk ka plotësuar kriteret dhe duhej kualifikuar, pasi nuk ka plotësuar kapacitetin ekonomik dhe financiar pasi ka paraqitur për punë të ngjashme një investim i cili ka karakter të ndryshëm, pra natyrë të ndryshme nga ai i prokurimit, në këto kushte tenderi duhej të anulohet. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “**D.**” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën 2,409,554 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.9.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **2,409,554 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.10.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “**Sistemim asfaltim rruga Staravec-Shimcan Zimur**”, për vlerën prej **41,250,000 lekë**, me OE të shpallur fitues “**S.**” Shpk, për vlerën prej 40,676,020 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 573,980 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim vetëm OE i shpallur fitues. Lidhur me këtë procedurë ka rezultuar se OE i shpallur fitues nga KVO nuk ka plotësuar kriteret dhe duhej kualifikuar, pasi edhe pse ka paraqitur vërtetim nga tatim taksat e bashkisë lidhur me detyrimet, rezulton se në zyrën e financës është debitor, për shkak të kontabilizimit të detyrimeve të rekomanduara nga KLSH, në këto kushte tenderi duhej të anulohet.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “**S.**” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën 41,250,000 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.10.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **41,250,000 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.11.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “**Sistemim asfaltim rruga Dovolan-Maqellarë**”, për vlerën prej **38,020,704 lekë**, me OE të shpallur fitues “**S.**” Shpk, për vlerën prej 37,637,573 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 383,131 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim vetëm 2 OE. Lidhur me këtë procedurë ka rezultuar se OE i shpallur fitues nga KVO nuk ka plotësuar kriteret dhe duhej kualifikuar, pasi edhe pse ka paraqitur vërtetim nga tatim taksat e bashkisë lidhur me detyrimet, rezulton se në zyrën e financës është debitor, për shkak të kontabilizimit të detyrimeve të rekomanduara nga KLSH, në këto kushte tenderi duhej të anulohet.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “S.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën 38,020,704 lekë**, veprime në pajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.11.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **38,020,704 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.12.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Sistemim asfaltim i rrugëve në zonat ku ka mbaruar Ujësjetësi i Ri*”, për vlerën prej **22,083,333 lekë**, me OE të shpallur fitues “**E.**” Shpk, për vlerën prej 20,340,648 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 1,742,685 lekë, procedurë në të cilën kanë marrë pjesë në prokurim 9 OE. 4 nga OE nuk kanë paraqitur ofertë, ndërsa 4 nga OE janë skualifikuar pasi kanë rezultuar me mangësi në dokumentacion nga të cilat 1 me ofertë më të lartë. Lidhur me këtë procedurë ka rezultuar se OE i shpallur fitues nga KVO nuk ka plotësuar kriteret dhe duhej s’kualifikuar, pasi nuk ka plotësuar dokumentacionin për mjetin Asfaltoshtues dhe mjetin Bitumatrice, nuk ka plotësuar kriterin fabrikën e betonit pasi mungon certifikata e pronësisë, si dhe nuk ka plotësuar kriterin e teknikut të ndërtimit pasi nuk ka paraqitur dokument për ing. ndërtimi.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “E.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen Standarde të Tenderit, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën 22,083,333 lekë**, veprime në pajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.12.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **22,083,333 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.13.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Sifoni Brezhdan-Vakuf, Dibër*”, për vlerën prej **14,727,966 lekë**, me OE të shpallur fitues “**N.**” Shpk, për vlerën prej 13,724,521 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 1,003,445 lekë, procedurë në të cilën kanë marrë pjesë në prokurim 10 OE dhe ku ka rezultuar se OE i shpallur fitues nga KVO nuk ka plotësuar kriteret dhe duhej kualifikuar, pasi nuk ka paraqitur vërtetim nga tatim taksat e Bashkisë Durrës.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “**N.**” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen Standarde të Tenderit, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën 13,724,521 lekë**, veprime në pajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I Lartë

C.II.13.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **13,724,521 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasojë me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

C.II.14.Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rinovim i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, Bashkia Dibër:

- Në situacionin përfundimtar sasia e zërit “FV hekur betoni Φ 8 mm, për zgara” është 60.6 ton. Libri i masave paraqet në mënyrë të detajuar 75.6 ton (73 ton nga zgarat ($14\Phi 8/m^2$ shtresë betoni = $5.53 \text{ kg}/m^2$) + 0.447 ton nga stolat + 2.112 ton nga themelet e mureve). Nga verifikimi i projektit të zbatimit rezulton se zgarat metalike kanë $10\Phi 8/m^2$ shtresë betoni. Nga verifikimi në terren konstatohet se nuk është vendosur hekur $\Phi 8$ mm, por hekur $\Phi 4$ mm. Nga rillogaritja rezulton se volumi i këtij zëri pune është 15.764 ton. Për pasojë, volumi prej 44.839 ton, me vlerë **5,326,355 lekë me tvsh**, është punim i kryer në mospërputhje me specifikimet teknike, me projektin e zbatimit dhe preventivin e punimeve dhe është shpenzim joefektiv i kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve (*trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në situacionin përfundimtar sasia e këtij zërit “FV shtresë pllakë guri e verdhë + gri, $t=8\text{cm}$ ” është 11965 m^2 , me çmimin e ofertës $2849 \text{ lekë}/m^2$. Libri i masave paraqet në mënyrë të detajuar 12898 m^2 , si shumë e sipërfaqeve të bulevardit kryesor dhe sipërfaqeve të degëzimeve + shiritat gri gjatësor dhe tërthorë. Nga verifikimi i objektit në terren, rezulton se trashësia e pllakës së gurit të vendosur nuk e kalon $t=5 \text{ cm}$, ndërsa në projektpreventiv dhe situacion, trashësia e pllakës është $t=8 \text{ cm}$. Nga rillogaritja (referuar analizës së paraqitur nga vetë ofertuesi), çmimi i zërit të punës “FV shtresë pllakë guri e verdhë, $t=8\text{cm}$ është më i madh se fakti me $586.8 \text{ lekë}/m^2$ ($1326/8*3 \times 1.18$). Për pasojë, diferenca e çmimit prej $586.8 \text{ lekë}/m^2$ (për të gjithë sipërfaqen e shtruar me këto pllaka prej 11965 m^2), e cila është përfituar nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën totale **8,425,274 lekë me tvsh**, është shpenzim joefektiv i kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve (*trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- “Box parafabrikat i kompletuar për furnizimin e ndriçimit” me vlerë 1,000,000 lekë, nuk është parafabrikat por me mur tulle dhe pa respektuar përmasat e përcaktuara në projektin e zbatimit.

- “Shtylla ndriçimi dekorative me dy krahë, me vlerë totale 1,066,464 lekë, janë realizuar me një ndriçues rrethor.

- Pusetat e betonit me kapak gize 40x40x40, me vlerë totale 251,384 lekë janë të përmasave më të vogla dhe pa kapak gize, por të mbuluara me pllakë guri.

Shuma totale prej **2,317,848 lekë pa tvsh**, është **shpenzim joefektiv** i kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve (*trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. Në objektin “Ndërtimi i shkollës së mesme të përgjithshme Maqellarë”, Bashkia Dibër:

-Zëri i punës “FV vetratë d/alumini plastike me dopioxham” me vlerë të situacionuar 1,724,195 lekë, nuk është kryer sipas përshkrimit të bërë në preventiv.

Vlera prej **1,724,195 lekë pa tvsh**, është **shpenzim joefektiv** i kryer nga sipërmarrësi i punimeve dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve (*trajtuar më hollësisht në faqet 131-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

C.II.14.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa që për kontratat publike, të caktojë nëpunës për monitorimin e kontratës, i cili të pasqyrojë gjendjen faktike të realizimit të kontratës, cilësinë e punimeve dhe grafikut të punimeve, para certifikimit të punimeve të realizuara.

Menjëherë

C/III. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA në vlerën 29,908,406 lekë)

C.III.1.Gjetje nga auditimi. Në Bashkinë Dibër dhe Njësitë Administrative Maqellarë, Muhur, Melan, Kastriot, Fushë-Çillën, Zall-Reç, Zall- Dardhë, Kala e Dodës, Lurë, Aras, Slllovë, Qëndër Tomin, Luzni, Selishtë dhe Bashkia Peshkopi, në fund të vitit 2017 janë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 95 subjekte në shumën 3,153,359 lekë dhe familjarët në vlerën 20,024,480 lekë (6.439 familje për taksë toke në vlerën 2,613,600 lekë, 10.091 familje për taksë ndërtese në vlerën 3,985,020 lekë, taksë pastrimi për 6.772 familje në vlerën 10,504,800 lekë dhe 3.652 familje për tarifa shërbimi ndriçim në vlerën 2,024,460 lekë). Sektori i Tatim Taksave për arkëtimin e debitorëve nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920 ”Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar dhe nenin 12 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve

Vlera e detyrimeve të mësipërme nuk është pasqyruar në kontabilitet dhe si rezultat nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare si detyrim i lindur dhe më pas vlera e arkëtuar të kreditonte këtë detyrim. Në pasqyrat financiare pasqyrohet vetëm vlera e arkëtuar në total pa u pasqyruar detyrimi që kanë subjektet. Veprimet e arkëtimit mbahen jashtë kontabilitetit (*trajtuar më hollësisht në faqet 35-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I mesëm

C.III.1.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër të merren masat për tu pasqyruar në kontabilitet, pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor, detyrimi i lindur i planifikuar i subjekteve të biznesit të vogël, subjekte të biznesit të madh, i subjektet familjarë, për shlyerjen e taksave e tarifave vendore.

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Dibër të marrë masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 95 subjekte debitorë në shumën 3,153,359 lekë, dhe familjarët në vlerën 20,024,480 lekë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar.

A- Të vendoset masa e detyrimit tatimorë, ashtu siç parashikohet në nenin 91, të ligjit nr 9920, pika 1 ku thuhet: “...nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin tatimor të tij”.

-Nuk është vepruar me sekuestrimin e pasurive të subjekteve, siç parashikohet në nenin 93, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, Pika 1 ku thuhet: “ Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit”.

B - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

Menjëherë

C.III.2.Gjetje nga auditimi. Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Dibër, nuk ishte arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje të pajisura me leje legalizimi nga Drejtoria e ALUIZ-it Dibër për periudhën (gusht 2015 deri 31.12.2017) për 170 raste me një vlerë prej 6,730,567 lekë shumë kjo e cila nuk është ngarkuar në llogarinë 468 debitor në persona, veprim në papajtueshmëri me pikën 5 të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim (*trajtuar më hollësisht në faqet 35-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Niveli i Prioritetit

I ulët

Vlera e mësipërme prej 6,730,567 lekë ka prioritet dhe ndikim të ulët në pasqyrat financiare për mos pasqyrimin në llogarinë debitorë në persona dhe pa pasqyruar në bilancin e vitit.

C.III.2.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër të merrni masat për tu pasqyruar në kontabilitet, në pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor, të bashkëpunojë me ZVRPP Dibër për parandalimin e regjistrimit dhe njoftimin e 170 qytetarëve dhe subjekte për pagesën në vlerën prej 6,730,567 lekë deri në likuidimin e plotë të kësaj vlere për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D/L. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet nr. 8, datë 04.07.2018 deri nr. 21, datë 04.07.2018, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore apo administrative), për **12** (dymbëdhjetë) punonjës dhe ish-punonjës, si më poshtë:

1. z. E. S., në cilësinë e anëtarit të NJP, për procedurat e prokurimit:

“Rinovimi i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, viti 2016

“Rikonstruksion i ish zyrave Ndërmarrja ish Rruga Ura Peshkopi+ sistemi i ngrohjes+ rrethim i jashtëm i objektit”, viti 2016

“Sistemim asfaltim i rrugëve ne lagje ku ka mbaruar Ujësjetësi i Ri”, viti 2016

“Sistemim asfaltim rruga Borde Dohoshisht Peshkopi Njësia Administrative Luzni”, viti 2016

“Shërbim projektim objektit rikonstruksion i rrugës kryesore ish-NBSH deri ish-SMT”, viti 2016

“Shërbim Projekt zbatim i objektit sistemim i përroit te Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha”, viti 2016

“Rikonstruksion i varrezave publike Bashkia Peshkopi”, viti 2016

“Sistemim, asfaltim rruga Staravec-Shimcan, Zimur”, viti 2017

“Sistemim, asfaltim rruga Dovolani Maqellare”, viti 2017

“Kanale ujitëse Set-Dardhë dhe Muhurr-Brezhdan”, viti 2017

Rehabilitim kanale ujitëse Llixha-Brezhdan-Kander, Venishtm, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Projekte asfaltimi të rrugëve të fshatrave”, viti 2017

“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse NJ.A. Sllovë, Luzni, Selishtë, Kastriot dhe F. Cidhen të Bashkisë Dibër”, viti 2017

“Blerje makine teknologjike, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Blerje dru zjarri”, viti 2017

“Rikonstruksion i shkollës së C.U. Rreth Kale, NJ.A. Muhur, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Rehabilitim i varrezave të dëshmorëve, Dibër 2017-2018”, viti 2017

“Rehabilitim i fushës së mbetjeve urbane të bashkisë Dibër”, viti 2017

“Rikonstruksion i urës HD=5 m, fshati Lishan i Poshtëm, NJ.A. Luzni”, viti 2017

2. z. U. M., në cilësinë e anëtarit të NJP, për procedurat e prokurimit:

“Përmirësim i infrastrukturës vendore dhe Rivitalizimi i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës”, viti 2016

“Ndërtimi i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë”, viti 2016

“Rikonstruksion i ish zyrave Ndërmarrja ish Rruga Ura Peshkopi+ sistemi i ngrohjes+ rrethim i jashtëm i objektit”, viti 2016

“Sistemim asfaltim i rrugëve ne lagje ku ka mbaruar Ujësjetësi i Ri”, viti 2016

“Sistemim asfaltim rruga Borde Dohoshisht Peshkopi Njësia Administrative Luzni”, viti 2016

“Shërbim projektim objektit rikonstruksion i rrugës kryesore ish-NBSH deri ish-SMT”, viti 2016

“Shërbim Projekt zbatim i objektit sistemim i përroit te Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha”, viti 2016

“Rikonstruksion i varrezave publike Bashkia Peshkopi”, viti 2016

“Sistemim, asfaltim rruga Staravec-Shimcan, Zimur”, viti 2017

“Sistemim, asfaltim rruga Dovolani Maqellare”, viti 2017

“Kanale ujitëse Set-Dardhë dhe Muhurr-Brezhdan”, viti 2017

Rehabilitim kanale ujitëse Llixha-Brezhdan-Kander, Venishtm, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Projekte asfaltimi të rrugëve të fshatrave”, viti 2017

“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse NJ.A. Sllovë, Luzni, Selishtë, Kastriot dhe F. Cidhen të Bashkisë Dibër”, viti 2017

“Blerje makine teknologjike, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Blerje dru zjarri”, viti 2017

“Rikonstruksion i shkollës së C.U. Rreth Kale, NJ.A. Muhur, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Rehabilitim i varrezave të dëshmorëve, Dibër 2017-2018”, viti 2017

“Rehabilitim i fushës së mbetjeve urbane të bashkisë Dibër”, viti 2017

“Rikonstruksion i urës HD=5 m, fshati Lishan i Poshtëm, NJ.A. Luzni”, viti 2017

3. z. J. B., në cilësinë e anëtarit të NJP, për procedurat e prokurimit:

“Rinovimi i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, viti 2016

“Përmirësim i infrastrukturës vendore dhe Rivitalizimi i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës”, viti 2016

“Ndërtimi i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë”, viti 2016

“Rikonstruksion i ish zyrave Ndërmarrja ish Rruga Ura Peshkopi+ sistemi i ngrohjes+ rrethim i jashtëm i objektit”, viti 2016

“Sistemim asfaltim i rrugëve ne lagje ku ka mbaruar Ujësjetllësi i Ri”, viti 2016

“Sistemim asfaltim rruga Borde Dohoshisht Peshkopi Njësia Administrative Luzni”, viti 2016

“Shërbim projektim objektit rikonstruksion i rrugës kryesore ish-NBSH deri ish-SMT”, viti 2016

“Shërbim Projekt zbatim i objektit sistemim i përroit te Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha”, viti 2016

“Rikonstruksion i varrezave publike Bashkia Peshkopi”, viti 2016

4. z. F. K., në cilësinë e anëtarit të NJP, për procedurat e prokurimit:

“Sistemim, asfaltim rruga Staravec-Shimcan, Zimur”, viti 2017

“Sistemim, asfaltim rruga Dovolani Maqellare”, viti 2017

“Kanale ujitëse Set-Dardhë dhe Muhurr-Brezhdan”, viti 2017

Rehabilitim kanale ujitëse Llixha-Brezhdan-Kander, Venishtm, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Projekte asfaltimi të rrugëve të fshatrave”, viti 2017

“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse N.J.A. Sllovë, Luzni, Selishtë, Kastriot dhe F. Cidhen të Bashkisë Dibër”, viti 2017

“Blerje makine teknologjike, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Blerje dru zjarri”, viti 2017

“Rikonstruksion i shkollës së C.U. Rreth Kale, N.J.A. Muhur, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Rehabilitim i varrezave të dëshmorëve, Dibër 2017-2018”, viti 2017

“Rehabilitim i fushës së mbetjeve urbane të bashkisë Dibër”, viti 2017

“Rikonstruksion i urës HD=5 m, fshati Lishan i Poshtëm, N.J.A. Luzni”, viti 2017

5. z. B. D., në cilësinë e anëtarit të NJP, për procedurat e prokurimit:

“Rinovimi i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, viti 2016

“Sifoni Brezhdan-Vakuf, Dibër”, viti 2016

6. z. E. Sh., në cilësinë e anëtarit të NJP, për procedurat e prokurimit:

“Përmirësim i infrastrukturës vendore dhe Rivitalizimi i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës”, viti 2016

“Ndërtimi i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë”, viti 2016

7. z. I. R., në cilësinë e anëtarit të NJP, për procedurat e prokurimit:

“Sifoni Brezhdan-Vakuf, Dibër”, viti 2016

8. z. F. M., në cilësinë e anëtarit të NJP, për procedurat e prokurimit:

“Sifoni Brezhdan-Vakuf, Dibër”, viti 2016

9. z. L. C., në cilësinë e Kryetarit të KVO, për procedurat e prokurimit:

“Përmirësim i infrastrukturës vendore dhe Rivitalizimi i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës”, viti 2016

“Ndërtimi i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë”, viti 2016

“Rikonstruksion i ish zyrave Ndërmarrja ish Rruga Ura Peshkopi+ sistemi i ngrohjes+ rrethim i jashtëm i objektit”, viti 2016

“Sifoni Brezhdan-Vakuf, Dibër”, viti 2016

“Sistemim asfaltim i rrugëve ne lagje ku ka mbaruar Ujësjetllësi i Ri”, viti 2016

“Sistemim asfaltim rruga Borde Dohoshisht Peshkopi Njësia Administrative Luzni”, viti 2016

“Shërbim projektim objektit rikonstruksion i rrugës kryesore ish-NBSH deri ish-SMT”, viti 2016

“Shërbim Projekt zbatim i objektit sistemim i përroit te Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha”, viti 2016

“Rikonstruksion i varrezave publike Bashkia Peshkopi”, viti 2016

“Sistemim, asfaltim rruga Staravec-Shimcan, Zimur”, viti 2017

“Sistemim, asfaltim rruga Dovolan Maqellare”, viti 2017

“Kanale ujitëse Set-Dardhë dhe Muhurr-Brezhdan”, viti 2017

“Projekte asfaltimi të rrugëve të fshatrave”, viti 2017

“Blerje makine teknologjike, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Rehabilitim i varrezave të dëshmorëve, Dibër 2017-2018”, viti 2017

“Rehabilitim i fushës së mbetjeve urbane të bashkisë Dibër”, viti 2017

“Rikonstruksion i urës HD=5 m, fshati Lishan i Poshtëm, N.J.A. Luzni”, viti 2017

10. zj. K. R., në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurat e prokurimit:

“Përmirësim i infrastrukturës vendore dhe Rivitalizimi i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës”, viti 2016

“Ndërtimi i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë”, viti 2016

“Rikonstruksion i ish zyrave Ndërmarrja ish Rruga Ura Peshkopi+ sistemi i ngrohjes+ rrethim i jashtëm i objektit”, viti 2016

“Sifoni Brezhdan-Vakuf, Dibër”, viti 2016

“Sistemim asfaltim i rrugëve ne lagje ku ka mbaruar Ujësjetësi i Ri”, viti 2016

“Sistemim asfaltim rruga Borde Dohoshisht Peshkopi Njësia Administrative Luzni”, viti 2016

“Shërbim projektim objektit rikonstruksion i rrugës kryesore ish-NBSH deri ish-SMT”, viti 2016

“Shërbim Projekt zbatim i objektit sistemim i përroit te Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha”, viti 2016

“Rikonstruksion i varrezave publike Bashkia Peshkopi”, viti 2016

“Sistemim, asfaltim rruga Staravec-Shimcan, Zimur”, viti 2017

“Sistemim, asfaltim rruga Dovolan Maqellare”, viti 2017

“Kanale ujitëse Set-Dardhë dhe Muhurr-Brezhdan”, viti 2017

“Projekte asfaltimi të rrugëve të fshatrave”, viti 2017

“Blerje makine teknologjike, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Rehabilitim i varrezave të dëshmorëve, Dibër 2017-2018”, viti 2017

“Rehabilitim i fushës së mbetjeve urbane të bashkisë Dibër”, viti 2017

“Rikonstruksion i urës HD=5 m, fshati Lishan i Poshtëm, N.J.A. Luzni”, viti 2017

11. z. K. S., në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurat e prokurimit:

“Përmirësim i infrastrukturës vendore dhe Rivitalizimi i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës”, viti 2016

“Ndërtimi i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë”, viti 2016

“Rikonstruksion i ish zyrave Ndërmarrja ish Rruga Ura Peshkopi+ sistemi i ngrohjes+ rrethim i jashtëm i objektit”, viti 2016

“Sistemim asfaltim i rrugëve ne lagje ku ka mbaruar Ujësjetësi i Ri”, viti 2016

“Sistemim asfaltim rruga Borde Dohoshisht Peshkopi Njësia Administrative Luzni”, viti 2016

“Shërbim projektim objektit rikonstruksion i rrugës kryesore ish-NBSH deri ish-SMT”, viti 2016

“Shërbim Projekt zbatim i objektit sistemim i përroit te Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha”, viti 2016

“Rikonstruksion i varrezave publike Bashkia Peshkopi”, viti 2016

“Sistemim, asfaltim rruga Staravec-Shimcan, Zimur”, viti 2017

“Sistemim, asfaltim rruga Dovolan Maqellare”, viti 2017

“Kanale ujitëse Set-Dardhë dhe Muhurr-Brezhdan”, viti 2017

“Projekte asfaltimi të rrugëve të fshatrave”, viti 2017

“Blerje makine teknologjike, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Rehabilitim i varrezave të dëshmorëve, Dibër 2017-2018”, viti 2017

“Rehabilitim i fushës së mbetjeve urbane të bashkisë Dibër”, viti 2017

“Rikonstrukcion i urës HD=5 m, fshati Lishan i Poshtëm, N.J.A. Luzni”, viti 2017

12. zj. Z. Gj., në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurat e prokurimit:

“Rinovimi i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”.

“Sifoni Brezhdan-Vakuf, Dibër”, viti 2016

Për shkeljet e mëposhtme:

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJP ka rezultuar se ato kanë kufizuar numrin e OE pjesëmarrës pasi në hartimin e kriterëve të kualifikimit, NJP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së kriterëve, siç kërkohet shprehimisht nga VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, gjithashtu, disa nga kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar (si: numri prej 190 punonjësish duket shumë i madh dhe diskriminues dhe jo në përpjesëtim me volumin e punës dhe afatin e punimeve; gjendja në llogari bankare, numri i mjeteve apo certifikatave të cilat nuk kanë lidhje me zërat e punimeve që do të kryhen, etj).

Duke patur parasysh se, KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE/BOE e tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave në DST, si edhe faktin që në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, gjykojmë se vendimet e marra nga KVO për shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (këtu e në vijim AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (këtu e në vijim NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprime këto me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura dhe mos përputhje me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kriteret të paplota e konkretisht, janë në kundërshtim me nenin 1 *“Objekti dhe qëllimi”*, pika 2, germa (c, ç, d, dh), nenin 2 *“Parimet e përzgjedhjes”*, nenin 24 *“Anulimi i një procedure prokurimi”*, nenin 53 *“Shqyrtimi i ofertave”*, nenin 55 *“Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”*, si dhe nenin 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar.

Në 14 nga procedurat e mësipërme, nga ana e KVO si rezultat i kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE apo BOE me mangësi në dokumentacion, ka sjellë pasoja me efekte negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, në vlerën prej **534,869,385 lekë pa tvsh, dhe në 3 nga 14 raste** për dëmin ekonomik në vlerën prej 51,552,315 lekë, si rezultat i kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE apo BOE të cilët nuk kanë plotësuar kërkesat e DST, në të njëjtat kushte me OE e s’kualifikuar por me ofertë ekonomike më të lartë se ato të s’kualifikuar (*Trajtuar në faqet 43-131, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

D/II. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenet 7 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Dibër t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për dy mbikëqyrës dhe tre kolaudatorë punimesh, si më poshtë:

1. **200,000 lekë për Z. D. Xh.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: **“Rinovim i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, Bashkia Dibër**, me sipërmarrës punimesh OE “A. I. G. C.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **6,954,217 lekë me tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: **“Ndërtimi i shkollës së mesme të përgjithshme Maqellarë”, Bashkia Dibër**, me sipërmarrës punimesh OE “A. I. G. C.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **4,917,532 lekë me tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. **50,000 lekë për Z. G. I.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: **“Sistemim asfaltim rruga Borde - Peshkopi, Nj.A. Luzni”, Bashkia Dibër**, me sipërmarrës punimesh OE “S.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **3,105,722 lekë me tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: **“Sistemim asfaltim rruga Staravec – Shimçan - Zimur”, Bashkia Dibër** me sipërmarrës punimesh OE “S.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,997,682 lekë me tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

3. **200,000 lekë për Z. I. D.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: **“Rinovim i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, Bashkia Dibër**, me sipërmarrës punimesh OE “A. I. G. C.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **6,954,217 lekë me tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: **“Ndërtimi i shkollës së mesme të përgjithshme Maqellarë”, Bashkia Dibër**, me sipërmarrës punimesh OE “A. I. G. C.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **4,917,532 lekë me tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

4. **50,000 lekë për znj. M. K.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: **“Sistemim asfaltim rruga Borde - Peshkopi, Nj.A. Luzni”, Bashkia Dibër**, me sipërmarrës punimesh OE “S.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **3,105,722 lekë me tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

5. **50,000 lekë për A. B.**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: **“Sistemim asfaltim rruga Staravec – Shimçan - Zimur”, Bashkia Dibër** me sipërmarrës punimesh OE “S.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,997,682 lekë me tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Shënim: Për mbikëqyrësin e punimeve z. Z. M. dhe kolaudatorin z. A. B. në objektin “Sistemim asfaltim i rrugëve në lagje ku ka mbaruar ujësjellësi”, Bashkia Dibër, me dëm ekonomik 551,228 lekë pa tvsh, nuk shikohen shkelje të cilat duhet të shoqërohen me masë administrative me gjobë.

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjën “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dibër që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj marrjen e masës disiplinore, **për 6 punonjës**, si më poshtë:

E.1 Largim nga shërbimi civil”, neni 58 germa “ç”

1. z. L. C., me detyrë Drejtor i Zyrës së Financës.

Për shkeljet e kryera në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e mëposhtme:

“Rinovimi i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, viti 2016

-“Përmirësim i infrastrukturës vendore dhe Rivitalizimi i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës”, viti 2016

-“Ndërtimi i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë”, viti 2016

-“Rikonstruksion i ish zyrave Ndërmarrja ish Rruga Ura Peshkopi+ sistemi i ngrohjes+ rrethim i jashtëm i objektit”, viti 2016

-“Sifoni Brezhdan-Vakuf, Dibër”, viti 2016

-“Sistemim asfaltim i rrugëve ne lagje ku ka mbaruar Ujësjiellësi i Ri”, viti 2016

-“Sistemim asfaltim rruga Borde Dohoshisht Peshkopi Njësia Administrative Luzni”, viti 2016

-“Shërbim projektim objektit rikonstruksion i rrugës kryesore ish-NBSH deri ish-SMT”, viti 2016

-“Shërbim Projekt zbatim i objektit sistemim i përroit te Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha”, viti 2016

-“Rikonstruksion i varrezave publike Bashkia Peshkopi”, viti 2016

-“Sistemim, asfaltim rruga Staravec-Shimcan, Zimur”, viti 2017

-“Sistemim, asfaltim rruga Dovolani Maqellare”, viti 2017

-“Kanale ujitëse Set-Dardhë dhe Muhurr-Brezhdan”, viti 2017

-“Projekte asfaltimi të rrugëve të fshatrave”, viti 2017

-“Blerje makine teknologjike, Bashkia Dibër”, viti 2017

-“Rehabilitim i varrezave të dëshmorëve, Dibër 2017-2018”, viti 2017

-“Rehabilitim i fushës së mbetjeve urbane të bashkisë Dibër”, viti 2017

-“Rikonstruksion i urës HD=5 m, fshati Lishan i Poshtëm, N.J.A. Luzni”, viti 2017

Në cilësinë e kryetarit të KVO edhe pse ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE/BOE e tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, është konsideruar mos përmbushje e kërkesave të DST, vendimet e marra nga KVO për shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, duke mos anuluar këto procedura, veprime këto me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura dhe mos përputhje me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kritere të paplota e konkretisht, janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (c, ç, d, dh), nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, si dhe nenin 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në 14 nga procedurat e mësipërme, nga ana e KVO si rezultat i kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE apo BOE me mangësi në dokumentacion, ka sjellë pasoja me efekte negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me economicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, në vlerën prej **534,869,385 lekë pa tvsh, dhe në 3 nga 14 raste** për dëmin ekonomik në vlerën prej 51,552,315 lekë, si rezultat i kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE apo BOE të cilët nuk kanë plotësuar kërkesat e DST, në të njëjtat kushte me OE e s’kualifikuar por me ofertë ekonomike më të lartë se ato të s’kualifikuar.

2. zj. Z. Gj., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve Gjimore.

Për shkeljet e kryera në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e mëposhtme:

“Rinovimi i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, ku si rezultat i kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE me mangësi në dokumentacion dhe skualifikimit të OE me ofertë më të ulët ka sjellë pasoja me efekte negative, dëm ekonomik në vlerën prej **20,047,517 lekë pa tvsh**.

“Sifoni Brezhdan-Vakuf, Dibër”, viti 2016, ku, si rezultat i kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE me mangësi në dokumentacion, ka sjellë pasoja me efekte negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, në vlerën prej **14,727,966 lekë pa tvsh**.

E.2 “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa (b, c)

3. z. F. K., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve

Për shkeljet e kryera në cilësinë e anëtarit të NJP, lidhur me kriteret e përcaktuara për procedurat e prokurimit të mëposhtme:

“Sistemim, asfaltim rruga Staravec-Shimcan, Zimur”, viti 2017

“Sistemim, asfaltim rruga Dovolani Maqellare”, viti 2017

“Kanale ujitëse Set-Dardhë dhe Muhurr-Brezhdan”, viti 2017

Rehabilitim kanale ujitëse Llixha-Brezhdan-Kander, Venisht, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Projekte asfaltimi të rrugëve të fshatrave”, viti 2017

“Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse NJ.A. Sllovë, Luzni, Selishtë, Kastriot dhe F. Cidhen të Bashkisë Dibër”, viti 2017

“Blerje makine teknologjike, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Blerje dru zjarri”, viti 2017

“Rikonstrukcion i shkollës së C.U. Rreth Kale, NJ.A. Muhur, Bashkia Dibër”, viti 2017

“Rehabilitim i varrezave të dëshmorëve, Dibër 2017-2018”, viti 2017

“Rehabilitim i fushës së mbetjeve urbane të bashkisë Dibër”, viti 2017

“Rikonstrukcion i urës HD=5 m, fshati Lishan i Poshtëm, NJ.A. Luzni”, viti 2017

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJP ka rezultuar se ato kanë kufizuar numrin e OE pjesëmarrës pasi në hartimin e kriterëve të kualifikimit, NJP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së kriterëve, siç kërkohet shprehimisht nga VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, gjithashtu, disa nga kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar (si: numri prej 100 punonjësish duket shumë i madh dhe diskriminues dhe jo në përpjesëtim me volumin e punës dhe afatin e punimeve; gjendja në llogari bankare, numri i mjeteve apo certifikatave të cilat nuk kanë lidhje me zërat e punimeve që do të kryhen, etj).

4. z. B. D., me detyrë Specialiste Personeli në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore

Për shkeljet e kryera në cilësinë e anëtarit të NJP, lidhur me kriteret e përcaktuara për procedurat e prokurimit të mëposhtme:

“Rinovimi i infrastrukturës së bulevardit “Elez Isufi”, rrugës “Safet Zhulali” dhe rrugës së “Muzeut”, viti 2016

“Sifoni Brezhdan-Vakuf, Dibër”, viti 2016

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJP ka rezultuar se ato kanë kufizuar numrin e OE pjesëmarrës pasi në hartimin e kriterëve të kualifikimit, NJP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së kriterëve, siç kërkohet shprehimisht nga VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, gjithashtu, disa nga kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar (si: numri prej 190 punonjësish duket shumë i madh dhe diskriminues dhe jo në përpjesëtim me volumin e punës dhe afatin e punimeve apo

prej 50 punonjësish; gjendja në llogari bankare, numri i mjeteve apo certifikatave të cilat nuk kanë lidhje me zërat e punimeve që do të kryhen, etj).

5. z. E. Sh., me detyrë Drejtor i Planifikimit të Territorit, Urbanistikës dhe Pronave
Për shkeljet e kryera në cilësinë e anëtarit të NJP, lidhur me kriteret e përcaktuara për procedurat e prokurimit të mëposhtme:

“Përmirësim i infrastrukturës vendore dhe Rivitalizimi i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës”, viti 2016

“Ndërtimi i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Maqellarë”, viti 2016

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJP ka rezultuar se ato kanë kufizuar numrin e OE pjesëmarrës pasi në hartimin e kriterëve të kualifikimit, NJP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së kriterëve, siç kërkohet shprehimisht nga VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, gjithashtu, disa nga kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar (si: numri prej 100 punonjësish duket shumë i madh dhe diskriminues dhe jo në përpjesëtim me volumin e punës dhe afatin e punimeve; gjendja në llogari bankare, numri i mjeteve apo certifikatave të cilat nuk kanë lidhje me zërat e punimeve që do të kryhen, etj).

6. z. F. M., me detyrë Specialist në Sektorin e Ujërave
Për shkeljet e kryera në cilësinë e anëtarit të NJP, lidhur me kriteret e përcaktuara për procedurat e prokurimit të mëposhtme:

“Sifoni Brezhdan-Vakuf, Dibër”, viti 2016

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJP ka rezultuar se ato kanë kufizuar numrin e OE pjesëmarrës pasi në hartimin e kriterëve të kualifikimit, NJP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së kriterëve, siç kërkohet shprehimisht nga VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, gjithashtu, disa nga kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar (si: numri prej 20 punonjësish duket shumë i madh dhe diskriminues dhe jo në përpjesëtim me volumin e punës dhe afatin e punimeve; gjendja në llogari bankare, numri i mjeteve apo certifikatave të cilat nuk kanë lidhje me zërat e punimeve që do të kryhen, etj).

F. KALLËZIM PENAL:

Në zbatim të nenit 15 germa (gj), të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* dhe nenit 248, të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995 *“Kodit Procedurës Penale”*, i ndryshuar, *sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik* nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe aktet e tjera bashkëlidhur lidhur, për vlerësim dhe veprime të mëtejshme procedurale, **për 5 persona**, si vijon:

1. **H. F.**, me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK
2. **L. C.**, me detyrë Drejtor i Zyrës së Financës, në cilësinë e Kryetarit të KVO (për 4 procedura)
3. **K. S.**, me detyrë ish-Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Kujdesit Social, në cilësinë e anëtares të KVO (për 4 procedura)
4. **K. R.**, me detyrë ish-Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore, në cilësinë e anëtares të KVO (për 4 procedura)
5. **Z. Gj.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve Gjinore, në cilësinë e anëtares të KVO (për 1 procedurë)

Për 3 procedura prokurimi të hapura, të fituara nga shoqëria *“A. G. I. C.”* shpk, me fond limit me vlerën 345,438,973 lekë dhe oferta fituese në vlerën 339,269,335 lekë, me një diferencë më

pak nga fondi limit (kursim) në vlerën 6,169,638 lekë, ose në masën 1.7%, duke shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në të tri procedurat në shumën **51,552,315 lekë**.

Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Sistemim asfaltim rruga Borde Peshkopi Nj.A. Luzni*”, zhvilluar më datë 01.08.2016, për vlerën prej **54,358,444 lekë**, me OE të shpallur fitues “**S.**” Shpk, për vlerën prej 52,484,134 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 1,874,310 lekë, pasi kanë përzgjedhur dhe shpallur fitues OE me ofertë ekonomike më të madhe se BOE i skualifikuar dhe nga mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik, i cili nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen Standarde të Tenderit, si dhe nga s’kualifikimi i BOE me ofertë më të favorshme ekonomike kanë shkaktuar përdorim e fondeve publike me efekt financiar në vlerën **5,006,519 lekë**.

G. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

H. Kontratat e punimeve të lidhura midis Bashkisë Dibër dhe operatorëve ekonomik të shpallur fitues në procedurat e prokurimit, zbatimi i të cilave është në proces (*si pasojë e zgjatjes së afateve të punimeve*), do të jenë objekt në auditimin e radhës që do kryhet në Bashkinë Dibër.

Në rastin e fillimit të procedurave gjyqësore në funksion të zbatimit të këtij rekomandimit për “Masa për shpërblim dëmi”, nga ana e Bashkisë Dibër, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke informuar njëkohësisht KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor.

Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi përkatës i përcillen Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Dibër.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R